



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 56 shkronja b të Statutit të Komunës nr. 01-1/298-10, nenet 8 dhe 11 të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400 dhe Rregullores për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400, sipas Rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës Nr. 02-020/04-5017/17, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, Kryetari i Komunës së Podujevës , merr:

VENDIM

PËR MBËSHTETJE FINANCIARE SHOQATËN E ARSIMTARËVE SPORTIV NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Shoqata e Arsimitarëve Sportiv, për realizimin e garave shkollore sportive dhe turneun tradicional që mbahet në fshatin Kërpimëh më 05.05.2017, për nderë të Dëshmorëve dhe të Rënëve në Komunën e Podujevës, mbështetet me mjete financiare në shumë 735.00 €.

Neni 2

Mjetet buxhetore ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe përmes bankës barten në llogarinë e Shoqatës së Arsimitarëve Sportiv.

Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Nr. 02-400/04-0028814/17

**Podujevë,
18 prill 2017**



**Kryetari i Komunës
Agim Veliu**